

## **REKOMANDIMI NR (98) 14**

### **I KOMITETIT TË MINISTRAVE TË SHTETEVE ANËTARE MBI INTEGRIMIN GJINOR (MAINSTREAMING)**

**(Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 7 tetor 1998 në takimin e 643-të të Zëvendësministrave)**

Komiteti i Ministrave, sipas kushteve të Nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës, duke vlerësuar se qëllimi i Këshillit të Evropës është arritja e unitetit më të madh midis anëtarëve të tij me qëllim, mbrojtjen dhe promovimin e idealeve dhe parimeve të cilat janë trashëgimia e tyre e përbashkët;

Duke konsideruar se arritja efektive e barazisë ndërmjet femrave dhe meshkujve është pjesë integrale e këtyre idealeve dhe parimeve;

Duke patur parasysh, në këtë kontekst, Deklaratën e Këshillit të Evropës mbi barazinë e burrave dhe grave, të miratuar më 16 nëntor 1988;

Duke patur parasysh se objektivat e caktuara përpara në deklaratë dhe në platformën për veprim të miratuara nga Kombet e Bashkuara në Konferencën e katërt Botërore për Gratë (Pekin, 1995);

Duke kujtuar Deklaratën e miratuar në Samitin e Dytë të Këshillit të Evropës (tetor 1997), në të cilën kryetarët e shteteve dhe qeverive të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës theksojnë "rëndësinë e një përfaqësimi më të balancuar të burrave dhe grave në të gjitha sektorët e shoqërisë, duke përfshirë edhe jetën politike ", dhe duke bërë thirrje për " progres të vazhdueshëm në këtë fushë me synimin për të arritur barazinë e mundësive efektive mes burrave dhe grave ";

Duke pasur parasysh Deklaratën mbi barazinë midis grave dhe burrave si kriter themelor të demokracisë, të miratuar në Konferencën e katërt ministrore Europiane mbi barazinë midis burrave dhe grave (Stamboll, nëntor 1997);

Të bindur se një nga strategjitë kryesore të efektshme për të arritur barazinë mes grave dhe burrave është Mainstreaming gjinor;

Duke përshëndetur raportin mbi Mainstreaming gjinor, të prodhuar nga Komiteti Drejtues mbi barazinë midis grave dhe burrave (CDEG), vendosja e kornizës konceptuale për Mainstreaming gjinor dhe një metodologji për zbatimin e tij, i shoqëruar nga shembujt e praktikës së mirë;

Të bindur se zbatimi i strategjisë për Mainstreaming gjinor jo vetëm që do të promovojë barazinë gjinore midis grave dhe burrave, por gjithashtu do të rezultojë në një përdorim

më të mirë të burimeve njerëzore, përmirësim të vendim-marrjes dhe do të përmirësojë funksionimin e demokracisë,

Rekomandon se qeveritë e shteteve anëtare duhet të marrin masa për:

- përhapjen e gjerë të raportit të Komitetit Drejtues të Barazisë Gjinore mbi Mainstreaming gjinor dhe inkurajimin për një përdorim sa më të gjerë të këtij koncepti dhe plani pune si një mjet për zbatimin e kësaj strategjie në sektorin publik dhe privat;
- inkurajimin e vendim-marrësit për të marrë në konsideratë vlerësimet e raportit me qëllim që të krijojnë një mjedis të mundur dhe kushtet të përshtatshme për të lehtësuar zbatimin e Mainstreaming gjinor në sektorin publik.